

Inspektimi, Testet dhe Marrja në Dorëzim e Mallit

1. Marrja në dorëzim e mallit do të realizohet në tre (3) procese të ndara, si më poshtë:

a. Procesi i parë – Dorëzimi i mallit

Konsiston në lëvrimin/prurjen e mallit pranë QFT Patos, brenda afatit të përcaktuar në Grafikon e Dorëzimit, përpara Komisionit të Marrjes në Dorëzim të Mallit.

b. Procesi i dytë – Këqyrja dhe inspektimi i mallit

Ky proces përfshin ekzaminimin, inspektimin dhe verifikimin fizik, vizual dhe cilësor të mallit, në raport me:

- prodhuesin dhe origjinën e mallit;
- afatin e garancisë;
- cilësinë dhe standardet përkatëse;
- ambalazhimin;
- dokumentacionin shoqërues;
- testimin e mallit, kur ky i fundit gjykohet i nevojshëm nga Komisioni.

Procesi i këqyrjes dhe inspektimit kryhet nga Komisioni i Marrjes në Dorëzim të Mallit, i zyrtarizuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, menjëherë pas dorëzimit të mallit të ambalazhuar sipas kërkesave kontraktuale. Furnizuesi ka të drejtë të marrë pjesë gjatë këtij procesi dhe të njihet me raportet e aktivitetit të përgatitura nga Komisioni.

2. Pranimi përfundimtar i mallit

c. Procesi i tretë – Marrja në dorëzim përfundimtare

Marrja në dorëzim e mallit do të kryhet nga i njëjti Komision, vetëm pasi malli të jetë konstatuar se përmbush plotësisht:

- specifikimet teknike;
- kërkesat e kësaj kontrate;
- dokumentet standarde të tenderit;
- ofertën e paraqitur nga Furnizuesi.

Pas marrjes në dorëzim përfundimtare, QFT Patos do të kryejë menjëherë hyrjen e mallit në magazinë dhe do të pranojë faturën tatimore të shitjes, në cilësinë e blerësit, vetëm pasi Komisioni të ketë vënë në dispozicion aktet përkatëse. Inspektimet dhe testet do të kryhen në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike, pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

3. Vendi i kryerjes së inspektimeve dhe testeve

Të gjitha inspektimet dhe testet do të kryhen pranë QFT Patos, në përputhje të plotë me specifikimet teknike të kontratës.

Dorëzimi dhe Realizimi i Kontratës

1. Vendi i dorëzimit të mallrave
2. Dorëzimi i mallrave do të kryhet në QFT Patos.
3. Dërgesat dhe dokumentacioni shoqërues
4. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë sa vijon:

- a. Kushtet, datat dhe vendet e dorëzimit të mallrave do të përmbushen në përputhje me Grafikun e Dorëzimeve, të parashikuar në specifikimet teknike, pjesë e kësaj kontrate.
 - b. Furnizuesi do të njoftojë Blerësin, sipas kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike, përpara çdo dorëzimi të mallrave.
 - c. Njoftimi i dorëzimit do të bëhet me shkrim (postë elektronike ose formë tjetër zyrtare) në adresën: Albpetrol sh.a., Selia Qendrore, Rruga Fier–Patos, Km 7.
5. Afati i fillimit dhe zbatimit të kontratës
- Data e fillimit të kontratës është data e nënshkrimit të saj ose data tjetër e përcaktuar në kontratë, ndërsa periudha e zbatimit do të jetë sipas afateve të përcaktuara kontraktualisht.